

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve

---

**VENDIM**  
**Nr.58 Datë 08.09.2010**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË**  
**“RUDNAP ENERGY TIRANA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E**  
**TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, gërma “g”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma a, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.09.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “RUDNAP ENERGY TIRANA” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Tregëtimit të Energjise Elektrike,

**Dhe konstatoi se:**

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1)
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)
- o Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3)
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10)

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me bilancin e tre viteve të fundit të shoqërisë është në pritje për t`u plotësuar. (neni 9 pika 3, gërma “c”)

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licensë të shoqërisë “RUDNAP ENERGY TIRANA” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve

- 
1. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**

---

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”10  
963  
Tirane  
69 590  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)